**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova / Republic of Kosovo**
**Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Dragash Municipality**
**Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš
02 Nr. Br. 020/01-3457/24
07.02.2024
Dragash - Dragaš

# RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2023

**Dhjetor 2023**

Në kuadër të DKRS vepron sektori i Kulturës, Rinisë e Sportit. Bazuar në planin e punës për vitin 2023 të paraqitur dhe të miratuar nga Asambleja Komunale, Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport gjatë këtij periudhe raportuese ka bërë përpjekje maksimale në realizimin e të gjitha detyrave dhe objektivave me qëllim që në tërësi të realizoi planin dinamik të aktiviteteve për këtë vit kalendarik. Marrë në përgjithësi prioritet për drejtorinë ka qenë shënimi i festave kombëtare po gjithashtu rëndësi i është kushtuar edhe aktiviteteve të tjera kulturore, rinore e sportive.
Më poshtë po i paraqesim aktivitetet e realizuara se bashku me angazhimet e përgjithshme.

***Tabela e aktiviteteve të organizuara për periudhën Janar - Korrik 2023***

| *Aktivitetet e organizuara dhe të mbështetura nga DKRS* | *Përshkrimi i aktivitetit* | *Muaji* |
|---|---|---|
| *Takim me të rinjtë e komunës* | ▪ Në këtë takim u diskutua mundësia e rritjes se drejtimeve profesionale, me theks të veçante drejtimet: TIK, Dizajn dhe Turizëm. Synimi i vetëm në këtë drejtim është që të rinjve e të rejave tu jepet mundësia, tu ofrohen kushte dhe cilësi të mira arsimore, në mënyrë që ata të vazhdojnë shkollimin në drejtimet e lartë cekura apo dhe drejtime tjera në Komunën e Dragashit. | *Janar* |
| *Festivali i valles dyshe "DYSHJA NA BASHKON" - Bujanoc* | ▪ Në ketë festival ka marrë pjesë SHKA" Bresana" dhe me sukses ka prezantuar vlerat kulturore të komunës tonë në mesin e shumë ansambleve dhe shoqërive pjesëmarrëse nga të gjitha territoret ku jetojnë dhe është shpërblyer me vendin e III-të dhe çmimin e karrierës për valltarin më të mirë. | *Janar* |
| *Flaka e Janarit* | ▪ Orë letrare me nxënës të Shkollës së Mesme "Ruzhdi Berisha" në përkujtim të jetës dhe veprës së heronjve Jusuf e Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka. | *Janar* |

| | | |
|---|---|---|
| ***17 Shkurti - Dita e Pavarësisë*** | ▪ Akademi Solemne, vendosja e kurorave tek shtatorja e Komandantit Legjendar Adem Jashari, varrezat e Dëshmorëve në Dragash e në fshatin Buçe.<br>▪ Turnir i futbollit me nxënësit e të gjithë shkollave fillore<br>▪ Turnir i futbollit me mësuesit e të gjithë shkollave fillore<br>▪ Turnir i volejbollit me vajzat e shkollës së mesme "Ruzhdi Berisha" | ***Shkurt*** |
| ***Epopeja e UÇK-së*** | ▪ Akademi Solemne, vendosja e kurorave tek shtatorja e Komandantit Legjendar Adem Jashari, varrezat e Dëshmorëve në Dragash e në fshatin Buçe.<br>▪ Turnir i futbollit me të gjitha institucionet<br>▪ Turnir i futbollit me nxënësit e shkollës së mesme "Ruzhdi Berisha" | ***Mars*** |
| ***Festivali i Valleve Dyshe "Dyshja na bashkon" - Shkup*** | ▪ SHKA"Bresana" shpërblehet me çmimin: Vallja më e mirë burimore | ***Prill*** |
| ***Festivali "Hasi Jehon"*** | ▪ SHKA"Bresana" me sukses ka prezantuar vlerat kulturore nga komuna jonë | ***Maj*** |
| ***Festivali Folklorik "Anadrinia Jehon"*** | ▪ SHKA"Bresana" shpërblehet me vendin e II-të për prezantim të suksesshëm të vlerave kulturore e artistike të komunës tonë | ***Maj*** |
| ***5 Maji - Dita e Dëshmorëve të Atdheut*** | ▪ Akademi Solemne, vendosja e kurorave tek shtatorja e Komandantit Legjendar Adem Jashari, varrezat e Dëshmorëve në Dragash e në fshatin Buçe<br>▪ Program artistik<br>▪ Realizuar në bashkëpunim me OVL të UÇK-së – Dega në Dragash | ***Maj*** |

| | | |
|---|---|---|
| ***Organizimi i Ditës së Goranëve (Dzuren da se ne zabraj)*** | ▪ Manifestim kulturor i realizuar në bashkëpunim me OJQ "DEMOKRATSKA OMLADINA GORE" | ***Maj*** |
| ***Organizimi i Ditës së Goranëve*** | ▪ Realizuar në bashkëpunim me *OJQ" SENSA "* | ***Maj*** |
| ***Hartimi i Planit për Rini*** | ▪ Ky aktivitet realizohet në kuadër të projektit "Përforcimi i bashkëpunimit mes të rinjve të Dragashit dhe Asamblesë Komunale", projekt që implementohet nga Qendra Rinore"AVOKO"e që mbështetet nga Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor 2 - ReLOaD 2, financuar nga Bashkimi Evropian e Komuna e Dragashit dhe zbatuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). | ***Maj - Korrik*** |
| ***Trajnim për mësimdhënës në mbështetje të vajzave për qasje në arsim të lartë*** | ▪ "Në Mbështetje të Vajzave të reja në Dragash për Qasje në Arsim të Lartë" i organizuar nga Qendra Rinore "AVOKO"DKRS, DKA e që u mundësua nga Austrian Development Agency. | ***Maj*** |
| ***1 Qershori – Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve*** | ▪ Tryezë diskutimi me të rinjtë në Qendrën Rinore "AVOKO" | ***Qershor*** |
| ***1 Qershori – Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve*** | ▪ Program artistik me fëmijë dhe nxënës të të gjitha shkollave të komunës tonë | ***Qershor*** |
| ***Sofra Ymer Prizrenit*** | ▪ Manifestimi tradicional "Sofra e Ymer Prizrenit", i organizuar në fshatin Zgatar në bashkëpunim me OJQ " KROI I MACES". | ***Qershor*** |
| ***Festivali Folklorik Mbarëkombëtarë "Hani i Elezit"*** | ▪ SHKA"Bresana" shpërblehet me vendin e I-rë për prezantim të vlerave kulturore e artistike të komunës tonë | ***Qershor*** |

| | | |
|---|---|---|
| ***Dita e Çlirimit të Komunës*** | ▪ Akademi Solemne ,vendosja e kurorave tek Shtatorja e Komandantit Legjendar Adem Jashari, Varrezat e Dëshmorëve në Dragash e në fshatin Buçe.<br>▪ Ceremonia e nderimit të pensionistëve ( administrata, arsimi e shëndetësia )<br>▪ Hapja e këndit të kurajos<br>▪ Program artistik me SHKA"Bresana" dhe këngëtarë të mirënjohur.<br>▪ Meetingu i parë i motocross i realizuar në bashkëpunim me Klubin e Motoristëve *"ENDURO SHARRI"* me pjesëmarrje të klubeve nga disa komuna të Kosovës.<br>▪ Gara tradicionale e vrapimit të kuajve dhe tërheqja e trupave me peshë e realizuar në bashkëpunim me *Klubin e Kuajve "OPOJA"*. | ***Qershor*** |
| ***Festivali i Gjirokastrës – Shqipëri*** | ▪ Pjesëmarrje e SHKA "Bresana" në kuadër të grupit pjesëmarrës nga Kosova. | ***Qershor*** |
| ***Festivali Ballkanik i Folklorit të Valleve "Opoja Vallëzon"*** | ▪ Festivali ka zgjatur tre ditë dhe është realizuar në bashkëpunim me *SHKA "BRESANA"*.<br>▪ Ansamblet dhe Shoqëritë kulturo-artistike që përformuan ishin nga Kosova, Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Ukraina, Polonia, Turqia, Bullgaria e Sanxhaku | ***21-22 -23 Korrik*** |
| ***"Ditët e Mërgatës" - Liqeni i Breznës*** | ▪ Manifestim kulturor i organizuar në Liqenin e Breznës me pjesëmarrje të bashkatdhetarëve të të gjitha grupmoshave.<br>(Aktiviteti u realizua në bashkëpunim me *OJQ " QENDRA")* | ***Korrik*** |
| ***"Ditët e Mërgatës" – Zgatar*** | ▪ Turne në futboll ""Afrojmë diasporën përmes futbollit"<br>(Realizuar në bashkëpunim me KF"Opoja" dhe rininë e fshatit Zgatar.) | ***28 - 29 - 30 Korrik*** |

| | | |
|---|---|---|
| ***"Ditët e Mërgatës" – Brod*** | ▪ Manifestim kulturor i organizuar në fshatin Brod me pjesëmarrje të bashkatdhetarëve të të gjitha grupmoshave.<br>(Realizuar në bashkëpunim me *OJQ " ZAENO ZA BROD" dhe OJQ "DEMOKRATSKA OMLADINA GORE")* | ***Korrik*** |
| ***"Ditët e Mërgatës" – Restelicë*** | ▪ Manifestim kulturor i organizuar në fshatin Restelicë me pjesëmarrje të bashkatdhetarëve të të gjitha grupmoshave.<br>(Realizuar në bashkëpunim me *OJQ "BISER")* | ***Gusht*** |
| ***"Ditët e Mërgatës" - Restelicë*** | ▪ Manifestim kulturor i organizuar në fshatin Restelicë me pjesëmarrje të bashkatdhetarëve të të gjitha grupmoshave.<br>(Realizuar në bashkëpunim me *OJQ "EMKACBEND")* | ***Gusht*** |
| ***Dita e Rinisë*** | ▪ Takim me të rinjtë<br>▪ Pastrimi i qytetit<br>▪ Marsh me biçikleta<br>(Aktivitetet janë realizuar në bashkëpunim me Organizatën Rinore "AVOKO" ) | ***Shtator*** |
| ***Takim me të rinj*** | ▪ Përgatitja për tregun e punës në fushën e teknologjisë<br>(Aktiviteti është realizuar në bashkëpunim me Organizatën Rinore "AVOKO") | ***Tetor*** |
| ***28 Nëntori – Dita e Flamurit*** | ▪ Akademi Solemne, vendosja e kurorave tek shtatorja e Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe në varrezat e Dëshmorëve në Dragash e në fshatin Buçe<br>▪ Turnir në futboll për meshkuj<br>▪ Turnir në volejboll për femra<br>▪ Program artistik – SHKA"Bresana" | ***Nëntor*** |
| ***28 Nëntori - "Parada e Shqiptarëve" - Tiranë*** | ▪ Pjesëmarrje e SHKA"Bresana" në aktivitetin e organizuar për nder të 111 vjetorit te pavarësisë. | ***Nëntor*** |

| | | |
|---|---|---|
| ***Takim me të rinj*** | ▪ Programet e ofruara nga Tech House dhe përvoja e të rinjve në fushën e teknologjisë dhe inovacionit.<br>(Aktiviteti është realizuar në bashkëpunim me Organizatën Rinore "AVOKO") | ***Nëntor*** |
| ***Takim informues me të rinjë për projektin "Zhvillimi dhe Promovimi i Turizmit në Dragash: Platforma Inovative "Visit Dragash"*** | ▪ Projekti "Zhvillimi dhe Promovimi i Turizmit në Dragash: Platforma Inovative 'Visit Dragash'", është mbështetur nga Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor 2, dhe është financuar nga Bashkimi Evropian dhe Komuna e Dragashit që zbatohet nga UNDP e implementohet nga Organizata Rinore "AVOKO"<br>"Visit Dragash" synon të jetë një platformë inovative që do të shërbejë si urë lidhëse midis vizitorëve dhe asaj se çfarë ofron Dragashi për turistë. Ne besojmë se ky projekt do të ndihmojë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe do të rrisë njohjen ndërkombëtare të komunës tonë si destinacion turistik. | ***Dhjetor*** |

Në mbështetje të Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L222 dhe Ligjit Nr. 04/L-116 nenin 58, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L040, nenit 5,7 dhe 8 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport, bazuar në Thirrjet Publike nga DKRS dhe Vendimet e Kryetarit të Komunës ka bërë subvencionimin e OJQ-ve, ku përfitues ishin:

| ***Nr.*** | ***Emri i OJQ*** | Emri i projektit | ***Vlera*** |
|---|---|---|---|
| **1.** | ***Klubi Futbollistik "OPOJA"*** | Zhvillimi dhe avancimi i KF"OPOJA" | ***33.000€*** |
| **2.** | ***Shkolla e Futbollit "Aroma Sport"*** | Ngritja e nivelit profesional për grup moshat e reja | ***4.500€*** |
| **3.** | ***Shkolla e Futbollit "Dragash Sport"*** | Najbolji promotor zajednistva i multietnicnosti Opstine | ***4.500€*** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 4. | *Klubi i Kuajve "OPOJA"* | Organizimi i garave të kuajve dhe pjesëmarrja e klubit në organizime kombëtare e ndërkombëtare | *9.000€* |
| 5. | *Klubi i Shahut "Sharri"* | Përkrahja për sportistët kulmorë | *4.000€* |
| 6. | *Klubi i Motoristëve" Enduro Sharri"* | Zhvillimi sportiv, rekreativ - moto sport | *3.000€* |
| 8. | *SHKA "Bresana"* | Manifestimet e Komunës, vlerat kulturore dhe ruajtja e folklorit | *11.000€* |
| 9. | *OJQ " Demokratska Omladina Gore"* | Organizimi i Ditës së Goranëve - Dzuren da se ne zabraj | *2.000€* |
| 10. | *OJQ "SENSA"* | Organizimi i Ditës se Goranëve | *4.000€* |
| 11. | *OJQ"Kroi i Maces"* | Organizimi i manifestimit "Sofra e Ymer Prizrenit" | *3.800€* |
| 12. | *SHKA "BRESANA"* | Festivali Ballkanik i Folklorit të Valleve - Opoja Vallëzon | *32.000€* |
| 13. | *OJQ "QENDRA"* | Ditët e Diasporës - Liqeni i Breznës | *4.000€* |
| 14. | *OJQ " ZAENO ZA BROD"* | Ditët e Diasporës - Brod | *3.000€* |
| 15. | *OJQ "DEMOKRATSKA OMLADINA GORE"* | Ditët e Diasporës - Brod | *3.000€* |
| 16. | *OJQ "BISER"* | Ditët e Diasporës - Restelicë | *3.000€* |
| 17. | *OJQ "EMKACBEND"* | Ditët e Diasporës - Restelicë | *3.000€* |

***Investimet kapitale në kuadër të DKRS***

| *Nr.* | *Investimet kapitale* |
|---|---|
| 1. | Ndërtimi i stadiumit të qytezës së Dragashit, investim në shumën prej i realizuar në mes të Komunës së Dragashit dhe Federatës së Futbollit të Kosovës. |
| 2. | Renovimi i Shtëpive të Kulturës në Brodosanë e Bellobrad |
| 3. | Ndriçimi i stadiumit në Bellobrad dhe Glloboçicë |
| 5. | Ndërtimi i stadiumit në fshatin Pllavë |
| 6. | Ndërtimi i stadiumit ne fshatin Blaç |

## ***RAPORTI STATISTIKOR I BIBLITEKAVE PËR VITIN 2023***

### ***FONDI LIBRAR DHE LEXUESHËRIA NË BIBLIOTEKËN AMË DHE NË DEGË***

| Në gjuhën | Shqipe | Boshnjake-Serbe | Turke | Të tjera | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|
| / | 13593 | 11140 | 146 | 622 | 25501 |

### **FONDI LIBRAR NË DEGË**

| Nr. | Degët | Shqipe | Serbe-boshnjake | Turke | Të tjera | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Biblioteka publike - Brezne | 8720 | | | 23 | 8743 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | Biblioteka publike - Bellobrad | 6969 | | | 20 | 6989 |
| 3 | Biblioteka publike - Brodosanë | 9413 | | | 60 | 9473 |
| 4 | Biblioteka publike- Blaç | 4480 | | | | 4480 |
| 5 | Biblioteka publike - Krushevë | 298 | 4784 | 44 | 175 | 5301 |
| 6 | Biblioteka publike - Brod | 22 | 5003 | 79 | 763 | 5273 |
| | Gjithsej | 29902 | 9787 | 123 | 419 | 40259 |

**FONDI LIBRAR NË BIBLIOTEKA AMË DHE NË DEGË**

| Në gjuhën | Shqipe | Boshnjake-Serbe | Turke | Të tjera | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|
| Gjithsej | 43495 | 20927 | 269 | 1041 | 65760 |
| Numri i librave për fëmijë | Nuk janë të ndara | | | | |
| Numri i librave të blera | 1656 | | | | 1656 Nga ministria |
| Numri i librave të blera për fëmijë | | | | | |
| Numri i librave të qitura jashtë përdorimit | | | | | |

## LEXUESIT DHE LIBRAT E LEXUARA SIPAS PËRBËRJA SOCIALE

| Në bibliotekat amë | Nxënës | Studentë | Punëtorë/e | Bujq | Amvise | Të tjerë | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Numri i lexuesve | 395 | | 31 | | | 42 | 468 |
| Numri i librave të lexuara | 680 | | 70 | | | 84 | 834 |

***Në degë***

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Numri i lexuesve | 1020 | 8 | 40 | | | 1 | Gjithsej<br>1069 |
| Numri i librave të lexuara | 1542 | 36 | 104 | | | 1 | 1683 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Numri i lexuesve në gjithë bibliotekat | 1415 | 8 | 71 | | | 43 | Gjithsej<br>1527 |
| Numri i librave të lexuara në gjithë bibliotekat | 2222 | 36 | 174 | | | 85 | 2517 |

## LEXUESIT DHE LIBRAT E LEXUARA SIPAS PËRBËRJËS NACIONALE

| Në bibliotekat amë | Shqiptarë | Serbe | Boshnjakë | Turq | Të tjerë | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Numri i lexuesve | 438 | | 30 | | | 468 |
| Numri i librave të lexuara | 793 | | 70 | | | 834 |

***Në degë***

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Numri i lexuesve | 1070 | | | | | 1069 |
| Numri i librave të lexuara | 1686 | | | | | 1686 |

***Gjithsej***

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Numri i lexuesve | 1508 | | 30 | | | 1527 |
| Numri i librave të lexuara | 2479 | | 70 | | | 2517 |

Krahas realizimit të aktiviteteve të parapara me planin e punës, drejtoresha e DKRS ka pas një bashkëpunim të vazhdueshëm me Ministrinë e Kulturës, Rinisë e Sportit dhe shumë organizata të tjera ku janë dorëzuar edhe shumë kërkesa për mbështetje materiale në të gjithë sektorët duke përfshirë edhe bibliotekat, muzeun etnografik dhe restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore e historike.

Gjithashtu në vazhdimësi ka marrë pjesë në mbledhjet e Qeverisjes Komunale, Mekanizmin Komunal Kundër Dhunës në familje, takimet publike, takime me përfaqësues të federatave të sportit e klube sportive si dhe organizata rinore.
Gjithashtu kemi pasur bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë Komunale të Arsimit në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta si dhe në lidhje me reformat dhe kushtet që mund t'i kenë të rinjtë.
Drejtoria ka ofruar raporte për Kryetarin e Komunës, informata për Kuvendin Komunal, komitetet përkatëse, Ministrinë Kulturës, Rinisë e Sportit, organizatat vendore e ndërkombëtare.
Me rastin e organizimit të aktiviteteve Drejtoria ka pasur mbështetje edhe nga partnerë të tjerë si: Policia e Kosovës, Ministria për Kulturë Rini dhe Sport, dhe disa OJQ lokale që kanë ndikuar në masë të madhe në numrin e aktiviteteve, suksesin dhe kualitetin e tyre.

***Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport***
***Drejtoresha***
***Lirdona Misinaj***